



Prishtinë: 02.09.2021
Kodi i ZRRE-së: V_1381_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_2131_02_21** tw dt.26.02.2021;
- Ankesën e konsumatorit;

në seancën e mbajtur më datë 02.09.2021 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit E.R nga Komuna e Lipjanit, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRRE/DMK_V_2131_02_21, i datës 26.02.2021.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve në ZRRE me datë 26.02.2021 ka marrë vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2131_02_21 me të cilin e ka refuzuar aprovuar pjesërisht ankesën e konsumatorit E.R nga Komuna e Lipjanit dhe e ka obliguar KESCO-n që konsumatorit t'ia korrigjoj faturën nr.04110DFE – 45797 të dt. 05.05.2011 në vlerë prej -563.95 EUR, duke e bërë shpërndarjen e kilovatëve (kWh) për periudhën 04/2011 deri në 12/2011.

I pakënaqur me vendimin e DMK-së, konsumatori E.R, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Në ankesën e konsumatorin nuk bëhet fjalë për falje të borxhit, por për fshirjen e tërësishme të tij, sepse është bërë gabim teknik në leximin e orës për muajin prill 2011 ku janë shtuar 10,000 kW;
- Në të njëjtin vit ora i rregullohet, kilovatët e shtuar hiqen, ndërsa borxhi në para nuk zbritet.
- Kërkon nga Bordi që të hiqet edhe vlera e borxhit që ka rezultuar nga gabimi teknik, sepse nëse hiqen kilovatët e shtuar, duhet hequr edhe borxhi i shtuar.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e konsumatorit se bëhet nuk fjalë për falje të borxhit, por për fshirje të tërësishme të tij, Bordi thekson se në vendimin e shkallës së parë të ZRRE-së, në asnjë paragraf nuk



është ngritur çështja e faljes së borxhit, mirëpo është sqaruar se nga shkresat e lëndës ka rezultuar se gjendja e faturuar për periudhën prill 2011 është e gabuar, përkatësisht konsumatori është mbingarkuar me 10,000 kWh dhe se është evidentuar që duhet të rregullohet kjo gjendje e shpenzimeve. Po ashtu, në procesverbalin e inspektimit me nr. 1061565 të dt. 05.07.2011 ekipi i KEK-ut ka evidentuar në procesverbal se gjendja reale e shpenzimeve në njehsor është TL=8139 kWh dhe TU=00003 kWh. Sipas rrjedhës se energjisë po ashtu konstatohet se gjendja e shpenzimeve në CCP është përmirësuar në periudhën 12/2011 duke bërë ndryshimin e gjendjes nga TL=90090 kWh dhe TU=00000 kWh në TL=84,481 kWh dhe TU=00000 kWh, por që kjo nuk ka rezultuar edhe në transaksionet e konsumatorit, përkatësisht nuk është bërë zbritja apo korigjimi financiar i faturave për shkak të mbingarkimit të konsumatorit në periudhën 04/2011.

Bordi duke pasur parasysh procesverbalin e inspektimit nr.1061565 të datës 05.07.2011, procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit nr.0133513 të datës 11.12.2012 si dhe procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit elektrik nr.15/12 të datës 12.11.2013 konstaton se konsumatorit duhet t'i bëhet korigjimi i faturave për periudhën 04/2011 deri në periudhën 12/2011 në vlerë **-563.95 EUR**.

Bazuar në të gjitha analizat e bëra konstatohet se KEK dhe KESCO nuk kanë vepruar konform nenit 28 paragrafit 1, 2 dhe 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: 1. *“Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifën tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme), 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit dhe 3. Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”.*

Andaj, nga sa u tha më sipër, pas shqyrtimit dhe administrimit të të gjitha provave, si rrjedha e energjisë elektrike, procesverbalin e inspektimit nr. 1061565 datë 05.07.2011, procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit nr. 0133513 datë 11.12.2012 si dhe procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit elektrik nr. 15/12 datë 12.11.2013 si dhe mos respektimin e nenit 28 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar argumente të qëndrueshme dhe prova tjera.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së,
- Konsumatorit E.R. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar